

**GJYKATA THEMELORE DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN**, me gjykatesen Vjollca Buzhala e me procesmbajtesen Melihate Shaipi , ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit Hatim Baxhaku nga Prizren , per shkak te kundevajtjes nga neni 5 , 6 par. 1 . 2 dhe nenit 8 par. 1 dhe 2 te Ligjit per deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe zyrtarve te larte public dhe deklarimin , prerjardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sanksionuar ne baze te nenit 17 par. 1. 1 te Ligjit te lartcekur e ne baze te nenit 195 te LMK-se me 16.09.2013 mori kete

### AKTVENDIM

I pandehuri Hatim Baxhaku nga i ati Sylejman I lindur me 1955 , nga Prizreni rr`` Sef Koshara `` pa nr. - Drejtor I departamentit te deges kirurgjike te Spitalit te Prizrenit , shqiptar, I martuar baba I 5 femijve, ka te kryer Fakultetin e mjeksise dhe specializimin .

### ESHTE PERGJEGJES

Sepse I pandehuri nuk ka bere deklarimin e rregullt vjejtore te pasurise ne afatin e rregullt ligjor deri me date 31.03.2012, deklarim I cili I obligon te gjithë zyrtaret e larte publikqe per pasurine e tyre te deklarohen rregullishte per qdo vite , sipas kerkeses se AKK e qe kete obligim ligjor nuk e ka permbushur mbrenda afatit .

-me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni neni 5 , 6 par. 1 . 2 dhe nenit 8 par. 1 dhe 2 te Ligjit per deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe zyrtarve te larte public dhe deklarimin , prerjardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sanksionuar ne baze te nenit 17 par. 1. 1 te Ligjit te lartcekur

### QORTIMI

### Arsyetimi

Sipas kerkeses se Agjencionit Antikurupcion ne Prishtine me numer 01-1810/2012 te dt. 18.05.2012, eshte ngritur procedura kundervajtese ndaj te pandehurit Hatim Baxhaku nga Prizreni , per shkak te kundevajtjes nga neni 5 , 6 par. 1 . 2 dhe nenit 8 par. 1 dhe 2 te Ligjit per deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe zyrtarve te larte public dhe deklarimin , prerjardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sanksionuar ne baze te nenit 17 par. 1. 1 te Ligjit te lartcekur

Gjendja faktike e pershkruar me persefermi si ne dispozitiv te ketij aktvendimi eshte vertetuar permes deklarates se pandehurit ne seancen verbale te dates 20.12.2012 I cili ne tersi ka pranuar kundervajtjen e cila I ngarkoht ne barre, duke theksuar se une deklarimin e pasurise e kame bere vetem 4 dite vones ku gjykatese si prove material ia prezentoj deftesen te leshuar ne poste me date 4.04.2012. Pjesrishte e pranon kundervajtjen e cila I ngarkoht ne barre duke theksuar se ne ate kohe kame qene jashte vendit dhe I kame dhene djalit tim qe te beje nje deklarim te tille I cili per shkak te neglizhences eshte vonuar.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA	
AGJENCIA RUNDER KURUPSIONIT AGJENCIA PRAKTIK KURUPSIONE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	
Dep.	<u>DPK/DMP</u>
Nr. I fan	
Nr. i detyrues	<u>02</u>
Nr. Protok	
Nr. Protok	<u>03-3070/13</u>
Data	
Data	<u>27-09-2013</u>

02-2070/13/02  
Rreth

Gjykatesi ndaj te pandehurit Hatim Baxhaku nga Prizreni ka aplikuar nenin 10 te LMK-se dhe te pandehurit ia ka shqiptuar qortimin pasiqe I pandehuri per here te pare ka kryer kesi lloji te kundervajtjesh, ndiej tejet I penduar , ekziston deshmi se I njejt nje deklarim te tille e ka bere me 4 dite vonese .

Andaj gjykatesi eshte I mendimit qe edhe me nje qortim do te ndikohet pozitivisht qe ne te ardhmen te mos te kryej kesoltoj kundervajtjesh, kjo shifet edhe nga shkresat ku I njejt e ka kryer obligimin meniher mbas kalimit te afaqtit.


Gjate caktimit te denimit jane vleresuar rrethanat nen te cilat eshte kryer kundervajtja, pesha e kundervajtjes se kryer dhe pasojat e saja, shkalla e pergjegjesise, si dhe rrethanat materijale te pandehures.

Me sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE DIVIZIONI PER KUNDERSHTRIMET NE PRIZREN**  
Nr. 452-05 /2012

te dt. 16.09.2013.

**Procesmbajtesja**  
**Melihate Shaipi**



**Gjykatesi**  
**Vjollca Buzhala**

**UDHEZIMI JURIDIK** Kunder ketij aktvendimi e ne afat brej 8 ditesh nga dorezimi mund te ushtrohet ankese Gjykates se Apelit Divizioni per Kundervajtje ne Prishtine, permes kesaj gjykate pa taksa.